



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR SUBVENCIONIMIN E SHOQATËS SË GASTRONOMËVE NË PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve Shoqatës së Gastronomeve, në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, 22/616/16306, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është dhënia e ndihmës për shkak të situatës pandemike të krijuar nga virusi COVID -19 dhe masave restriktive nga Qeveria e Republikës së Kosovës për mbyllje totale për periudhën 2-javore.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-451/02-87857/21, më 19.05.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kufeta

